



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:184814
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05253317

Ka. nr. 23/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik – Person Juridik “Best Tech”, SHPK, Njësia punuese në Lipjan, me numër të biznesit NRB. 8120160039, me pronar Enis Hajdini, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesë – MINT-së, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 832/2023, të datës 18.12.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 3, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Ushtruesi i Kërkesë – MINT-së, dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan v– Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 832/2023, i datës 18.12.2023 **sa i përket sanksionit kundërvajtës – gjobë së shqiptuar ashtu që të pandehurës për** veprën për të cilën është shpall përgjegjëse i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **3000(tremijë) €**, të cilën ka për ta paguar në afat prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, në bazë të Kërkesës së MINT - Inspektoratit të Tregut nr. 19/21 të datës 23.06.2023 me numër të protokollit 3695-19, me aktgjykim K. nr. 832/2023, të datës 18.12.2023 të pandehurin Subjektin Ekonomik – Person Juridik “Best Tech”, SHPK, Njësia punuese në Lipjan, me numër të biznesit NRB. 8120160039, me pronar Enis Hajdini, e ka shpall përgjegjëse sepse:

- me datën 25.04.2023 Inspektori i Tregut i MINT-së, Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut për Naftë dhe Derivate të Naftës, inspektoj “Best Tech” shpk, me NUI:812016039 me pronar Enis Hajdini për Njësine në Lipjan, gjatë inspektimit të kryer është kërkuar të prezantoj Licencën e NDN-së më Procesverbalin e inspektimit me Nr. 22/01140 për Operatorin Ekonomik “Best Tech” shpk, mirëpo pala prezentë nuk ka arrit ta prezantoj dokumentin e kërkuar ku i është dhënë afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, të prezantoj dokumentacionin përkatës të ushtrimit të veprimtarisë për shitje me pakicë të Naftës, Operatori Ekonomik “Best Tech”, shpk nuk posedon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë afariste, për çka është i obliguar me nenin 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/I-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, -
- me këtë i pandehuri ka kryer kundërvajtje neni 6 të Ligjit Nr. 08/L-018 Për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej **300 (treqind)€**, të cilën gjobë i Operatori Ekonomik gjegjësisht pronari ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi për Buxhetin e Kosovës, fletëpagesa mirëet në lokalet e kësaj gjykate e njëjta vlen edhe për paushallin gjyqësor. Po ashtu është obliguar Operatori Ekonomik gjegjësisht pronari që në emër të paushallit gjyqësor kësaj gjykate t’ia paguaj shumën prej **5(pesë)€**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse gjobën dhe paushallin nuk i paguan në afatin e dhënë, në vështirë të nenin 163 par.4 LMK-së, arkëtimi do të bëhet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Ushtruesi i Kërkesës MINT – Inspektorati i Tregut, ka paraqitur ankesë për shkak të aplikimit të gabuar të procedurës kundërvajtëse si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në arsyetim të ankesës veç tjerash thekson se:

gjykata gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, dhe gabim e ka vlerësuar gjendjen faktike sepse inspektorët e MINT-së, kanë inspektuar operatorin në fjalë dhe kanë konstatuar se e ushtrojnë veprimtarin pa Licencë –Leje për shitje me pakicë të NDN-së, me çka ka kryer kundërvajtjen nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/I-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, e cila sanksionohet me gjobë prej 5.000 € deri në 15.000 €. Konsiderojnë se dënim me gjobë është shumë prej 300€, është plotësisht në kundërshtim me ligjin për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, sepse i njëjti ende nuk është pajisur me Licencë andaj masat lehtësuese nuk mund të aplikohen në rastin konkret.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet, si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur nga të pandehurit, aktgjykimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa e paraqitur, është pjesërisht e bazuar ashtu që bëri ndryshimin sa i përket cilësimit juridik të kundërvajtjes.

Kolegji konstatoj se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të marrjes në pyetje të Përfaqësuesit – pronarit Ensi(Elmi)Hajdini, i cili ka deklaruar se subjekti ekonomik në fjalë në momentin e inspektimit nuk ka pas Licencë për ushtrimin e veprimtarisë shitje me pakicë të NDN-së, por janë në procedurë e sipër për tu pajisur me Licencë, në bazë të Procesverbalit mbi kontrollin inspektues Nr. 01140/22, të datës 10.05.2023, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se të pandehurit kanë kryer veprat kundërvajtëse, nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/I-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, sepse ka tregtuar NDN-së, pa Licencë, për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse, ndërsa sipas ligjit është i obliguar që të pajiset me Licencë para se të fillon me ushtrimin e veprimtarisë.

Numri i lëndës: 2023:184814
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05253317

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, vetëm sa i përket dënimit të shqiptuar ashtu që vepra kundërvajtëse për të cilën i dënuari është shpall përgjegjës nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/l-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, ni shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej **3000(tremijë)€**, e cila është përcaktuar sipas shkallës se përgjegjësisë, peshës se veprës se kryer, si rrethanave në të cilat është kryer vepra kundërvajtëse dhe se me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 23/2024, me datë 26.01.2024



Azra Cakolli